



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



Nr. 02-060/01-58982 dt. 10/11/ 2022

Në bazë të nenit 52 të Ligjit nr. 03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 42 pika 42.2 të Statutit të Komunës së Drenasit, nenit 12 pika 12.2 dhe nenit 21 pika 21.2 të Rregullores së punës të Kuvendit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës të Drenasit z. Milaim Hajdari, me dt. 17. 11.2022 (e Enjte) duke filluar në ora 10:00, në sallën e Bordit të Drejtorëve të Komunës.

THËRRET
Mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa

Mbledhja do të këtë:

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa i mbajtur më dt. 20. 10.2022.
2. Draft Propozim Plani i Veprimit për vitin 2023-2024, të Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal 2020-2024.
3. Propozim Vendim për caktimin e normave tatimore për Tatimin në Pronën e Paluajtshme për vitin 2023.
4. Të ndryshme.

Drenas, 10. 11.2022



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës


Milaim Hajdari



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



Nr. 02-060-56423 dt. 31.10 2022

PROCESVERBALI

I mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa të mbajtur më dt. **20.10.2022**, ora 10:00.

Mbledhjen e kryesoi: Milaim Hajdari- Kryesues

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes të Komitetit për Politikë dhe Financa ku të pranishëm ishin Nënkryetari i Komunsës Arben Shala, Kryesuesi i Kuvendit Milaim Hajdari, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa: Hamit Kastrati, Malsore Cakiqi, Azemine Bujupi Gjoka, Hamit Haxhiu, Arbër Halilaj, Florentina Elezi-Veliu si dhe Drejtori i Financave Shyqiri Bublatku.

1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa i dt. 21.09.2022.
2. Raporti Financiar Janar-Shtator 2022.
3. Propozim vendim për shpalljen e Prof.Dr. Rexhep Meidani "Qytetar Nderi" i Komunës së Drenasit.
4. Propozim vendim për shpalljen e Prof.Dr. Alfred Moisiu "Qytetar Nderi" i Komunës së Drenasit.
5. Propozim vendim për shpalljen e Prof.Dr. Bamir Topi "Qytetar Nderi" i Komunës së Drenasit
6. Propozim vendim për shpalljen e SH.T.Z Prof.Dr. Bajram Begaj "Qytetar Nderi" i Komunës së Drenasit.
7. Propozim vendim për shpalljen e SH.T.Z. Edi Rama "Qytetar Nderi" i Komunës së Drenasit.
8. Propozim vendim për shpalljen znj. Ana Roch "Qytetare Nderi" e Komunës së Drenasit.
9. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- pasi përshëndeti të pranishmit, deklaroi të hapura punimet e mbledhjes të Komitetit për Politikë dhe Financa, ku prezantoi rendin e ditës.

Arbër Halilaj, sa i përket rendit të ditës propozoj që nga pika e 3 deri tek pika e 8 t'i diskutojmë si pako, ndërsa në asamble veç e veç.

Nënkryetari i Komunës Arben Shala, theksoj se duhet ta shtojmë edhe një paragraf të ri tek paragrafi i tretë në propozim vendimet nga 3 deri tek 8, paragrafi: Titulli Qytetar Nderi sipas këtij propozim vendimi do të ndahet nga kryetari i komunës, i cili autorizohet të përcaktoj formën e dekoratës, mënyrën e dhënies si dhe çështjet tjera sa i përket organizimit të ndarjes së titullit.

Hamit Haxhiu, para se ta fillojmë rendin e ditës propozoj që me e shtu edhe një pikë në rendin e ditës, unë nuk jam kundër këtyre që do të shpallen qytetar nderi mirëpo pse mos me e shpallë edhe Sali Berishen qytetar nderi. Ndërsa sa i përket pikës së 8 kërkoj një sqarim për znj. Ana Roch. Dhe a jeni konsultu me ndonjë historian apo si keni vepru që keni ardh deri në shpalljen e qytetar nderi të këtyre që i keni propozu?

Nënkryetari i Komunës Arben Shala, znj. Ana Roch është me origjinë spanjolle, është Zvicrrane, ka kontribuar shumë për qendrën e promovimit të drejtave të grave i ka përkrah shumë dhe vazhdon ende t'i përkrah.

Florentina Elezi-Veliu, propozoj me hedh në rend dite një raport nga Drejtoria e Infrastrukturës Lokale për realizimin e Projekteve gjatë këtij viti dhe planifikimi për tre muajt e ardhshëm.

Meqë nuk pati diskutime të tjera kryesuesi hodhi në votim rendin e ditës me këto dy pika shtesë të propozuara me lartw: 1. **Propozim vendim për formimin e Komisionit për strukturën organizative dhe funksionale të fshatrave dhe lagjeve urbane me qëllim të organizimit dhe zgjedhjeve,** dhe 2. **Raport nga Drejtoria e Infrastrukturës Lokale për realizimin e Projekteve gjatë këtij viti dhe planifikimi për tre muajt e ardhshëm.**

Pasi që nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim rendin e ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me: 07 vota (Për), kundër nuk pati, abstenim nuk pati, u miratua rendi i ditës me dy pika shtesë të cekura me lartë nga kryesuesi dhe Florentina Elezi ndërsa pika të cilën e propozoi Hamit Haxhiu mbeti si rekomandim.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës: 1. **Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa i mbajtur më dt. 24.08.2022.**

Pasi që nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me: 07 vota (Për), kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e dytë të rendit të ditës: 2. **Raporti Financiar Janar-Shtator 2022.**

Drejtori i Financave Shyqiri Bublaku, sa i përket buxhetit të vitit 2022 Komuna e Drenasit e ka pas buxhetin e planifikuar dhe të aprovuar me 15,846,091.00 €, shpenzimet buxhetore për këtë periudhën kanë arritur vlerën prej: 10.186,186,715,55 €. Sa i përket realizimit të hyrave direkte është 978,717,30 €. Nuk është trend i kënaqshëm për shpenzimin e buxhetit mirëpo duke marrë parasysh ngritjen e qimeve të cilat kanë ndikuar drejtpërdrejt edhe në zhvillimin e

buxhetit dhe shpenzimin e buxhetit ku operatorët ekonomik nuk dojnë me vazhdu me kontratat të cilat i kanë pas të nënshkruara, çmimet e vitit të kaluara me këtë vit ka qenë shumë i madh dhe kemi pas pengesa në realizimin e disa projekteve.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari-hapi diskutimin për pikën e tretë deri tek pika e tetë të rendit të ditës.

Arbër Halilaj, “Qytetar nderi” është titulli apo statusi më i lartë i nderit që i jepet nga një qytet/komunë një individit shtetas i huaj ose vendas, i cili me veprimtarinë jetësore, angazhimin e tij të pashoq, trimërinë, sakrificën, arritjet shkencore apo prezantimin dinjitoz, ka bërë shumë për interesin e qytetit dhe banorëve të tij, aq sa respektohet e admirohet shumë, duke qenë i denjë për tu dalluar veçmas nga të tjerët me një titull nderi.

Zakonisht, titulli “Qytetar Nderi” nuk bart me vete ndonjë çmim monetar apo vlerë tjetër, duke mos i dhënë kështu kurrfarë ndryshimi statusit qytetar të individit të shpallur Q.Nd., pra ka vetëm vlerën e çmuar simbolike. Ky titull natyrisht duhet të shoqërohet me një arsyetim të veçantë të dedikuar për bartësin e këtij titulli, në mënyrë që qytetarët të dinjë rreth jetës dhe veprimtarisë së atij që i bëhet ky nder.

Kuvendi Komunal, në këtë rast me propozimin e Kryetarit, dhe bazuar në Ligjin e V.L. dhe Statutin e Komunës, ka të drejtë të propozojë dhe të aprovojë Vendime për titujt e nderit, në mesin e tyre edhe për shpalljen Qytetar Nderi. Por, procedura e kërkon që së pari të kemi një Rregullore mbi dekoratat dhe titujt e nderit, ku do të përcaktoheshin të gjitha kriteret, mënyrën e propozimit dhe ndarjes së titullit, në raste të caktuara edhe të abrogimit të tij, si dhe procedurën e tërësishme nga propozimi e deri tek marrja e titullit në ceremoni zyrtare.

Poashtu, për të zbatuar këtë Rregullore dhe për të shqyrtuar propozimet, duhet të kemi të formuar një Komision për ndarjen e titujve dhe dekoratave, të përbërë nga anëtarë Kuvendi dhe shoqëria civile, që nëpërmjet rregullave për vlerësimin e personave me merita dhe kontribut të veçantë për komunën tonë, do të çonte në vend idenë e shpërblimit të tyre me tituj nderi.

Faktet e cekura më lart tregojnë se Qytetar Nderi duhet të jetë një titull i veçantë e që jepet rrallë, vetëm për personalitete emblematike dhe të merituar, e jo si një Mirënjohje e zakonshme për arritje në një sferë jetësore, që edhe ajo e ka vlerën dhe rangun e vet. Për të dëshmuar se sa rrallë jepet ky titull në qytete të caktuara dhe sa i veçantë është si çmim, të shohim disa statistika në rajon:

- Shkupi nga viti 1921 deri më 2018, pra për gati 10 dekada, ka shpallë vetëm 16 veta si Qytetar Nderi.
- Spliti poashtu për 100 vjet, nga viti 1921 e deri me 2021 ka shpallur vetëm 12 vetë.
- Qyteti i Zagrebit nga viti 1853 dhe deri më sot, pra për 170 vite, ka shpallur vetëm 50 qytetarë nderi.
- Sarajeva nga viti 2000 deri më 2018 shpalli vetëm 5 qytetarë nderi.
- Në Shqipëri Bashkia e Shkodrës ka shpallur rreth 150 vetë, afërsisht sa ç’ka shpallë p.sh.: Viena nga viti 1797 e deri më sot,

gjë që tregon se si shqiptar jemi dorëlibër në dhënien me e pa kritere të këtij titulli nderi, për të cilin do të duhej të kishte Rregullore dhe kritere strikte brenda saj, e të cilën gjë po e kërkoj sot edhe për komunën tonë. Përndryshe, sa i përket personaliteteve të propozuara dhe veprimtarisë së tyre në interes të popullit dhe shtetit tonë, nuk kam ndonjë dilemë se a duhet apo jo të shpallen Qytetar Nderi të komunës sonë, por edhe në këtë proces duhet të miratojmë dhe zbatojmë rregulla.

Rrjedhimisht, unë propozoj që si pikë e veçantë e rendit të ditës të hyj *formimi i Komisionit për Dekorata dhe tituj nderi*, i cili së pari do të përpilonte Rregulloren për këtë çështje, pastaj të shqyrtoj propozimet që kemi para vetes, meqë kjo nuk është me urgjencë si dhe çdo propozim tjetër në të ardhmën. Duke qenë titulli më i lartë, numri i shpalljeve Qytetar Nderi brenda një viti kalendarik do të duhej të kufizohet, e poashtu të përcaktoheshin datat e rëndësishme festive kur ky titull do të jepej nga Kryetari i Komunës.

Në Rregullore do të përcaktonim edhe tituj të tjerë, si: Nderi i Qytetit-titulli më i lartë pas atij Qytetar Nderi, titullin me emrin “Fehmi e Xhevë Lladrovci” për kontribut të veçantë në veprimtari ushtarake, politike dhe diplomaci; titullin “Ymer Elshani” për personalitetet më të shquara të kulturës, artit dhe letërsisë, të dëshmuar me arritjet e tyre në nivel kombëtar e ndërkombëtar; Titullin për arritje dhe promovim të sportit dhe rinisë; titullin për aktivizëm qytetar; titullin për shërbim në komunitet, si dhe Mirënjohje e Falenderime të KK Drenas, me të cilat nderohen personalitete e institucione, të cilat kanë dhënë kontribut të veçantë e të rëndësishëm në fusha të ndryshme në të mirë të qytetit të Drenasit.

Përndryshe, secili nga ne kemi ide e propozime që të shpallim dikënd Qytetar Nderi apo për tituj të tjerë dhe për të mos pasur dilema, hezitime e debat të panevojshëm, kërkoj që këto propozime për Qytetar Nderi të procesohen në Asamble pasi të kemi përpiluar së pari Rregulloren për PROCEDURAT, MENYRAT DHE KRITERET PËR NDARJEN E TITUJVE TË NDERIT, të cilën si Draft ofrohem vullnetarisht që ta përpiloj brenda javës.

Nëse kjo kërkesë apo sugjerim injorohet dhe procedurat kryhen pa Rregullore dhe Komision, me urgjencë dhe pa bashkëpunim, atëherë unë abstenoj nga tërë procesi.

Florentina Elezi-Veliu, pajtohem me kolegun sepse së pari duhet të formohet një komision i cili e vlerëson se kujt me iu dhënë ky titull e kujt jo, dhe këto propozim vendime nuk janë me urgjencë, së pari u dashtë me e vë në rend dite formimin e komisionit.

Hamit Haxhiu, pa asnjë kontekst ndaj figurave politike, nuk jam kundër atyre, propozimi im ishte vetëm si shtesë ndaj këtyre pikave të cilat janë.

Pasi që nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim nga pika e tretë deri tek pika e tetë e rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me: 07 vota (**Për**), kundër nuk pati, abstenim nuk pati. Me rekomandimin e Arbër Halilaj që të formohet një rregullore mbi dekoratat dhe titujt e nderit.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e nëntë të rendit të ditës: **9. Propozim vendim për formimin e Komisionit për strukturën organizative dhe funksionale të fshatrave dhe lagjeve urbane me qëllim të organizimit dhe zgjedhjeve.**

Nënkryetari i Komunës Arben Shala, është e formuar edhe rregullorja, dhe në bazë të rregullores kërkohet edhe krijimi i komisionit i cili do të përfundoj këtë punë. .

Hamit Haxhiu, është një vlerë shumë e ulët për kompensim të pagës për administrator të fshatrave, në krahasim me kontributin e tyre.

Nënkryetari i Komunës Arben Shala, kjo është e përcaktuar me udhëzim administrativ nuk është një gjë që varet nga komuna mirëpo është e rregulluar me udhëzim administrativ.

Pasi që nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me: 07 vota (**Për**), kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e dhjetë të rendit të ditës: 10. Të ndryshme.

Pasi nuk pati diskutime të tjera kryesuesi e konsideroj të mbyllur mbledhjen, mbledhja përfundoj rreth orës 11:00 min .

Procesmbajtëse:



Liridona Fejza-Ajazi



Kryesuesi i Kuvendit Komunal



Milaim Hajdari



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Komuna e Drenasit

Zyra e Kryetarit



01- Nr 400/01-58467 dt. 09/11/2022

DRAFT PROPOZIM

PLANI I VEPRIMIT PËR VITIN 2023 -2024 TË

STRATËGJISË SË ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL 2020 - 2024

NËNTOR 2022

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1 pika (i) të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon: që në bazë të nenit 12 dhe 40 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (“Gaz.Zyrt. e Republikës së Kosovës”), nenit 34.6 pika të Statutit të Komunës së Drenasit; me nr; 01-110-6904 të dt; 24.09.2008, Dispozitave të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr. 03/L-049, Udhëzimi Administrativ (QRK) Nr. 07/2018 për Planifikimin Hartimin e Dokumenteve Strategjike dhe Planeve të Veprimit, në bazë të nenit 4 paragrafi 2 të Ndryshim Plotësimi i Statutit të Komunës së Drenasit me nr: 12-030-19523 të dt;06.04.2018, dispozitave të Udhëzimit Administrativ NR.04/2018 për Transparencën në Komuna, dispozitave të Udhëzimit Administrativ NR.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, dispozitave të Rregullores Nr.01/2017 për Procedurat e Hartimit dhe Publikimit të Akteve të Komunës si dhe Strategjisë së Zhvillim Ekonomik Lokal 2020-2024 të Komunës së Drenasit, dispozitave të Rregullores (QRK)Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, dispozitave të Statutit të Komunës së Drenasit, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datën 08.11.2022 të aprovoj:

PLANI I VEPRIMIT PËR VITIN 2023 -2024 TË

STRATËGJIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL 2020-2024

Plani i veprimit parasheh buxhetimin për vitin 2023-2024 i bazuar në Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik Lokal 2020-2024 dhe rekomandimeve nga MAPL.

Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal 2020-2024 është 5 vjeçare ndërsa plani i veprimit të saj ka qenë 3 vjeçare me rekomandim nga MAPL dhe MFPT është hartuar plani i veprimit për periudhën e mbetur 2022-2024 të dokumentit strategjik.

**Kryetari i Komunës**

Ramiz Eladrovci



REPUBLIKA E KOSOVES			
KOMUNA GLOGOC			
GLOGOC MUNICIPALITY			
Prenuar	09/11/	202	
Nj. Org.	Numër	Vlera	
03-432/01-58448			



KOMUNA E GLOGOCIT
DREJTORATI PËR BUXHET DHE FINANCA
Sektori i Tatimit në Pronë

Në mbështetje të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Ligjit Nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme nenit 9, si dhe në bazë të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon këtë:

PROPOZIMVENDIM

- **Për caktimin e normave tatimore për Tatimin në Pronën e Paluajtshme për vitin 2023**

Neni 1

Normat Tatimore

Në zbatim të Ligjit Nr. 06/L-005, për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, neni 9, paragrafi 1, nën paragrafët 1.1 deri 1.9, Kuvendi Komunal i Komunës së Glogocit cakton normat tatimore për vitin 2023 për të gjitha kategoritë e pronave, me përjashtim të kategorisë pronë publike, si vijon:

- Për njësitë bujqësore të parcelave-----0.15%
- Për njësitë bujqësore të objekteve-----0.15%
- Për njësitë pyjore të parcelave-----0.15%
- Për njësitë rezidenciale të parcelave-----0.15%
- Për njësitë rezidenciale të objekteve-----0.15%
- Për njësitë komerciale të parcelave-----0.16%
- Për njësitë komerciale të objekteve-----0.16%
- Për njësitë industriale të parcelave-----0.20%
- Për njësitë industriale të objekteve-----0.20%

Neni 2

Zbatimi

Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Zyra e Tatimit në Pronë.

Neni 3

Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi 8 ditë pas miratimit nga ana e Kuvendit Komunal dhe do të filloj së zbatuari nga 1 janari 2023.

Iu dërgohet:

- Komitetit për politikë dhe Financa
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Ministrisë për Financa
- Zyrës të Tatimit në Pronë
- Arkivit komunal

Vendimi Nr.

Datë:



Kryetari i Komunës
[Signature]
Ramiz Lladrovci